



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:240302
Datë: 15.08.2024
Numri i dokumentit: 06054709

C.nr.3627/2023

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtare Njomëza Berisha, në çështjen juridike kontestimore të paditëses D.B.M. me numër personal ... nga Prizreni të cilën me autorizim e përfaqëson av. B.K. nga Prizreni, kundër të paditurës (AAPARr), Prishtinë, me objekt të kontestit kompensimi i të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, vlera e kontestit 1,952.50 euro, jashtë seancës gjyqësore, më datë 15.08.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Pa shqyrtim kryesor të çështjes

I. APROVOHET në tërësi e bazuar kërkesëpadia e paditëses D.B.M. nga Prizreni, kundër të paditurës (AAPARr), Prishtinë për shkak të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit.

II. DETYROHET e paditura (AAPARr), që paditëses D.B.M. në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, për periudhën kohore prej datës 01.01.2021 deri më datë 31.01.2023 apo për 25 muaj (për çdo muaj shumë prej 78.10 euro, në shkallë prej 35% të pagës bazë- 459.00 euro, në emër të diferencës së papaguar të kualifikimit ose licencimit), t'ia paguajë shumë prej 1,952.50 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, nga dita e parashtrimit të padisë me datë 08.11.2023 e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbartimit të detyrueshëm.

III. DETYROHET e paditura, që paditësit, t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 134.00 euro, në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbartimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësja D.B.M. nga Prizreni, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson av.B.K. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi, kundër të paditurës (AAPARr), me objekt të kontestit kompensimi i të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, vlera e kontestit 1,952.50 euro.

Në padi, pala paditëse ka theksuar se paditësi është i punësuar si mësimdhënës pranë SHMP "Qendra e Kompetencës" në Prizren, ku vazhdon të punojë në këtë institucion. Meqenëse paditësi është i licencuar dhe e ka kualifikimin e mësimdhënësit në nivelin bachelor dhe master

me diplomë fakulteti, në bazë të nenit 7 të kontratës kolektive të datës 18.04.2017, të njëjtit i është garantuar e drejta në pagesën shtesë prej 35% të pagës bazë, çka e paditura këtë shtesë e paguan pjesërisht. Padiësi realizon pagën bazë prej 459.00 euro në muaj, ndërsa shtesën prej 35% e kësaj page apo shuma prej 160.65 euro e paditura ia paguan pjesërisht dhe atë në shumën prej 82.55 euro, duke i mbetur borxh shumën prej 78.10 euro, që nga data 01.01.2021 deri me datë 31.01.2023, apo në shumën e përgjithshme prej 1,952.50 euro, me kamatë ligjore prej 8%. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura, në përgjigjen në padi e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e padiësit si të pa bazuar, duke kërkuar që gjykata të njëjtën ta refuzoj si të pabazuar. Kërkesë padia është mbështetur Në Kontratën Kolektive Për Arsim të vitit 2017 nr.2056 ne kuptim të nenit 7 dhe e paditura vlerëson se asnjë dispozitë e kontratës kolektive nuk ka paraparë veprim retroaktiv lidhur me pagën dhe kompensimin gjatë marrëdhënies së punës. Padiës nuk ka dëshmuar se është anëtarë i sindikatës e paraparë me dispozitën e nenit 2 paragrafi 1.1 të kontratës kolektive për arsim, por edhe po të ishte, si anëtarë i sindikatës apo vet SBASHK-u nuk ka asnjë angazhim të vetëm apo shkresë drejtuar Ministrisë së Financave për sigurimin e mjeteve brenda mundësive financiare. Duke u bazuar ne ligjin për marrëdhënien e punës ne asnjë rrethanë nuk mund të vlerësohet se kompensimi i ushqimit gjatë punës është borxh kryesor, as më pakë të vlerësohet si dëm. prandaj edhe e paditura konstaton se kamata e kërkuar nga padiësi nuk është borxh kryesor apo se padiësit i është shkaktuar dëm.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 152 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e padiëses është në tërësi e bazuar, andaj pa shqyrtim të çështjes, e aprovoi kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ndërmjet palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se padiësja D.B.M. është në marrëdhënie pune tek e paditura, si mësimdhënës pranë SHMP “Qendra e Kompetencës” në Prizren. Mirëpo, kontestuese ishte nëse padiëses i takon e drejta e kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, përkatësisht diferencës konkrete të papaguar.

Gjykata përmes kontratës së punës nr. protokollit 137/3 e datës 02.10.2018, gjykata vërtetoi faktin se kualifikimi i padiëses është Fakultet të nivelit master. Po ashtu, një fakt i tillë vërtetohet edhe nga diploma e datës 22.05.2018, lëshuar në emër të padiëses.

Në vazhdim, bazuar në listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, vërtetohet se lartësia e pagës bazë të padiësit është në shumë prej 459.00 euro dhe se padiësit në emër të kualifikimit fakultet, në pagën bazë mujore i është paguar shuma prej 82.55 euro.

Provat e lartcekura, gjykata i pranoi si provë materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par. 1 të LPK-së, sipas së cilës dispozitë ligjore përcaktohet se “shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”. Andaj meqë këto dokumente janë të pranueshme edhe për vetë palën e paditur, pasi që të njëjtat nuk janë kontestuar, gjykata ia fali besimin e plotë.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33 të datës 29.08.2008. Kështu, në pikën 1. të këtij vendimi, përcaktohet që

“nga 1 shtatori 2008 të gjithë mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat e Republikës së Kosovës, do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit”. Ndërsa, në pikën 4. të vendimit në fjalë parashihet ngritja e pagës sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit, në të cilën përcaktohet se “mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional, të pajisur: 1). Me diplomë të Shkollës Normale përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 10%; 2). Me diplomë të Shkollës së Lartë Pedagogjike përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 19%; 3). Me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27% dhe 4). Me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35%”. Pastaj, bazuar në mendimin juridik nr. 214/2023 të datës 09.10.2023, në pikën I. të tij përcaktohet që “për kërkesat e mësimdhënësve për kompensim mbi bazën e kualifikimit (licencimit), kompensimi bëhet sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008”, vendim i cili ka qenë në fuqi deri më 06.02.2023.

Në rastin konkret, gjykata gjeti se e paditura ka për detyrim, që paditëses t’ia bëjë kompensimin mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, konform detyrimeve që rrjedhin nga Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008, sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit të përcaktuar në këtë vendim. Më konkretisht, nga lista e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës dhe kontrata e punës, rezulton se e paditura, në emër të kualifikimit apo licencimit në pagën bazë, ia ka paguar shumën prej 82.55 euro paditësit. Sipas pikës 4 nën pikës 2 të Vendimit nr.01/33 të datës 29.08.2008, paditësja përfiton ngritje prej 35% të pagës bazë, që në rastin konkret paditësi përfiton ngritje në pagën bazë, në emër të licencimit apo kualifikimit shumën prej 160.65 euro. Andaj, gjykata vendosi si në pikën nën I. dhe II. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e detyruar të paditurën që paditësit për çdo muaj t’ia paguaj shumën prej 78.10 euro apo diferencën e mbetur, për 25 muaj nga data 01.01.2021 deri më datë 31.01.2023, në shumë të përgjithshme prej 1,952.50 euro.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë më datë 07.11.2023, bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Gjykata me rastin e vendosjes jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në nenin 152 të LPK-së, ku parashihet që “po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim (neni 143 dhe 147 të këtij ligji), nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij”.

Lidhur me kundërshtimet tjera të palës së paditur dhënë në përgjigje në padi, gjykata vlerësoi se të njëjtat nuk janë të bazuara në dispozita ligjore dhe nuk kanë mbështetje në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritore.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 449 dhe 453 të LPK-së lidhur me nenin 463 par. 1 të LPK-së, duke obliguar të paditurën që në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, paditëses t’ia paguajë shumën e përgjithshme prej 134.00 euro, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, për përpilimin e padisë shumën prej 104 euro dhe për taksë gjyqësore shumën prej 30 euro.

Numri i lëndës: 2023:240302

Datë: 15.08.2024

Numri i dokumentit: 06054709

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në pajtim me nenin 143 lidhur me nenin 152 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil
C.nr.3627/2023 të datës 15.08.2024

Gjyqtare,
Njomëza Berisha

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit, pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.